

# SHQYRTIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIM PUBLIK



# Shqyrtimi i korrupsionit në prokurim publik

Prishtinë, dhjetor 2023


Autore: Albulena Nrecaj - Musliu

Me kontribut të veçantë të Arbër Kabashit, Monitorues

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamenti i Shtetit Amerikan.

*Përkrahur nga:*



## Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave.....	5
2. Përmbledhje ekzekutive.....	6
3. Metodologjia.....	8
4. Historiku i problemeve në OShP.....	9
4. Pasqyrë e përgjithshme e ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara.....	10
5. Ndryshimet e rregullave të “lojës”.....	11
5.1. Ndryshimi i kundërligjshëm rregullave të “lojës” dhe mungesa e transparencës .....	12
6. Statistikat e numrit ankesave sipas vlerës para amendamentimit të rregullores.....	14
7. Efikasiteti i shqyrtimit të prokurimit sipas rregullave të reja, në panele individuale.....	15
8. Vendimet e paneleve individuale pas ndryshimit të rregullores .....	17
9. Kohëzgjatja e shqyrtimit të ankesave dhe top vendimet më të vonuara.....	17
10. (D)efektet e shqyrtimit të ankesave dhe pasojat.....	19
11. Vlera dhe lloji i ankesave të (pa)zgjidhura brenda afateve kohore .....	20
12. Autoritetet kontraktuese ndaj të cilave ka më së shumti ankesa .....	21
13. Kalendari I 16 ankesave në shqyrtim .....	22
14. Konkluzione .....	23
15. Rekomandime .....	24

## **I. Lista e shkurtesave**

<b>AK</b>	Autoritet Kontraktues
<b>INPO</b>	Iniciativa për Progres
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>OShP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
<b>PSh</b>	Paneli Shqytrues
<b>RrUOPP</b>	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

## 2. Përmbledhje ekzekutive

INPO ka analizuar punën e Bordit të OShP-së, respektivisht paneleve shqyrtuese në zgjedhjen e lëndëve të ankesave gjatë periudhës janar - shtator 2023.

Gjatë kësaj periudhe në OShP janë deponuar 748 ankesa nga operatorë ekonomik. Mbi 84% e ankesave janë zgjidhur brenda kësaj periudhe, por vetëm 23% e tyre brenda afatit ligjor. 77% e ankesave në OShP janë zgjidhur jashtë afatit ligjor për vendimmarrje. Ndërkaq në shqyrtim janë 116 ankesa të cilave po ashtu ju ka skaduar afati i shqyrtimit bazuar në kalkulimin e afateve ligjore nga 30 shtatori 2023 kur edhe është deponuar ankesa e fundit për periudhën raportuese (Ankesa nr.748/23) deri në ditën e 34-të afatit ligjor e që është 5 nëntor 2023. Ky fond prej 116 ankesave që është në shqyrtim nuk është mostër e analizës së këtij raporti.

INPO ka gjetur se kjo mesatare e zgjidhjes së ankesave në OShP është 65 ditë.

OShP gjatë kësaj periudhe dy herë kishte plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren Nr.01/2020 të Punës së OShP me qëllim siç është thënë të rritjes së efikasitetit të punës. Fokus i të dyja ndryshimeve kishte qenë neni 21 i Rregullores bazë, i cili rregullon mënyrën e themelimit dhe përbërjes së paneleve shqyrtuese bazuar në vlerat e kontratave ndaj të cilave është ushtruar një ankesë. Ndryshimet e rregullores janë bërë në kundërshtim me LPP-në dhe në mungesë të plotë të transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesuara. Herën parë, ishte vendosur që ankesat për kontaktat në vlerë deri në 100,000.00Eur të shqyrtoheshin në panele individuale por që pas dy (2)muajve Bordi kishte ndryshuar këtë vlerë deri 300,000.00Eur. Në të dyja proceset e amendamentimit të rregullores nuk ishin zbatuar obligimet ligjore të konsultimit të publikut dhe paleve të interesuara, si dhe i gjithë procesi ishte zhvilluar me mungesë të plotë të transparencës. Pavaresisht, se rregullat e “lojës” kishin ndryshuar dy herë gjatë kësaj periudhe raportuese, INPO analizën krahasuese të efektshmërisë së ndryshimeve të paneleve individuale e ka fokusuar në dallimet e ndryshimeve të rregullores së datës 09.08.2023 dhe të Rregullores 01/2020. Pra, fokus i është dhënë vlerësimit të efikasitetit të paneleve shqyrtuese individuale që kanë shqyrtuar lëndë të ankesave deri në 300,000.00Eur.

Shumica e ankesave të depunonura në OShP deri në ndryshimin e rregullores i përkasin vlerave deri në 300,000.00Eur. Pas ndryshimit të vlerave të ankesave që do të shqyrtoheshin nga panele shqyrtuese individuale INPO ka gjetur se asnjë panel individual nuk e ka zgjidhur asnjë ankesë brenda afatit ligjor.

Edhe pse është amendamentuar rregullorja me qëllim të zgjidhjes sa ma të shpejtë të ankesave, INPO ka gjetur që përkundrazi koha mesatare shprehur në ditë është rritur nga 55 ditë, për zgjidhjen e një ankesë para amendamentimit të rregullores, në 63 ditë pas amendamentimit të rregullores, për vlerën e lëndëve të ankesave është deri në 300,000.00Eur.

Tutje, OShP është duke përdorur standarde të dyfishta të shqyrtimit të ankesave dhe duke aplikuar qasje diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë. Në korrik 2022, bordi kishte vendosur që të mos trajtoheshin ankesat të cilave Ju ka skaduar afati ligjor i shqyrtimit të tyre, ndërkohë që sot pjesa dërrmuese e vendimeve janë të nxjerra jashtë afatit ligjor. Po ashtu, OShP në Rregulloren për amendamentin e Rregullores 01/2020 nuk ka përcaktuar nëse rregullorja ka fuqi

prapavepruese, kësisoj ka vazhduar ti trajtoj ankesat e deponuara para hyrjes në fuqi të Rregullores me rregullat e reja.

Tutje, duke pas parasysh se shumica e lëndëve të trajtuara në OShP janë bërë përmes paneleve shqyrtuese individuale, INPO vë në pikëpyetje objektivitetin dhe karakterin e vendimmarrjes kolegjiale të OShP-së dhe parasheh si rrezik ekspozimin e zyrtarëve të Bordit ndaj korrupsionit dhe ndërhyrjeve të jashtme.

### 3. Metodologjia

Ky raport pasqyron aspektet e vendimmarrjes së shqyrtimit të prokurimit në OShP bazuar në rregullativën ligjore të aplikueshme. Me qëllim të analizimit të performancës së paneleve shqyrtuese në zgjidhjen e ankesave, INPO ka përdorur metodologji të kombinuar të analizës dhe hulumtimit. Përmes platformës elektronike [www.oshp.rks-gov.net](http://www.oshp.rks-gov.net). INPO ka bërë mbledhjen e të dhënave për të gjitha ankesat e parashtruara në OShP për periudhën nëntë (9) mujore Janar – Shtator 2023.

Analiza e trajtimit të ankesave nuk përfshinë vendimmarrjen në kuptimin e materies apo substancës së lëndës së shqyrtuar por fokusohet vetëm në aspektet e krahasimit të numrit të ankesave në raport me vendimet e nxjerra, afateve ligjore të nxjerrjes së vendimit, vlerës së lëndës së ankesave. Analiza përfshinë vlerësimin e efikasitetit të Bordit të OshP-së pas ndryshimit të rregullave për caktimin e paneleve shqyrtuese duke i krahasuar numrin e zgjidhjes së ankesave para dhe pas ndryshimit të rregullores së punës së OShP-së.

Subjekt i trajtimit të kësaj analize janë të gjitha ankesat e pranuar deri më 30 shtator 2023. Po ashtu, monitorimi përfshinë edhe periudhën e shqyrtimit e ankesës së fundit të pranuar, bazuar në afatin ligjor prej 34 ditë për shqyrtimin e ankesave. Rrjedhimisht, INPO ka trajtuar të dhënat e publikuara për këto ankesa deri më 5 nëntor 2023, pra datën e fundit kur do të duhej të zgjidhej ankesa e fundit me numër 748/23, e parashtruar më 30 shtator 2023. Shqyrtimi i lëndëve të bartuara nga viti paraprak nuk është trajtur në këtë raport.

INPO ka zhvilluar intervista të strukturuar me pyetje të hapura me Avokatë dhe Juristë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, janë kërkuar interpretime ligjore nga KRPP.

Gjetjet e hulumtimit janë diskutuar me OShP përmes takimeve zyrtare dhe shkëmbimeve përmes postës elektronike.



## 4. Historiku i problemeve në OShP

OShP është organ i pavarur i përbërë nga pesë (5) anëtarë, përkatësisht kryetari dhe katër (4) anëtarë, konkretisht “Qeveria i propozon Kuvendit së paku dy kandidatë për pozitën e lirë të kryetarit të OShP-së dhe së paku dy kandidatë për secilën pozitë të lirë të anëtarëve të OShP-së, të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë para skadimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve aktual. Kuvendi emëron kryetarin dhe secilin anëtarë të OShP-së, bazuar në rekomandimin e dhënë nga një organ përzgjedhës i pavarur”<sup>1</sup>

Ky organ edhe pse i pavarur ligjërisht, që nga themelimi i tij e deri më sot është përballur me probleme të shumta në aspekt të konstituimit, funksionalizimit dhe të pavarësisë e paanshmërisë. Hisedare më e madhe në këtë problematikë është Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës në secilën legjislaturë, të cilat asnjherë nuk kanë respektuar afatet kohore lidhur me konstituimin e anëtarëve apo bordit të OShP-së, përkatësisht asnjëherë nuk kanë zbatuar rregullën ligjore që procedurat e konkursit për anëtarë të rinj duhet të fillojnë së paku nëntëdhjetë (90) ditë para skadimit të mandatit të anëtarëve aktual apo brenda një periudhe të shpejtë të zgjedhin anëtarët të cilët për arsye të ndryshme janë larguar nga Bordi. Edhe pse ky organ që sipas ligjit është i pavarur, subjektet politike në vazhdimësi e kanë politizuar të njëjtin pa u brengosur fare për pasojat që prodhon një bord i politizuar dhe jofunksional.<sup>2</sup>

Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23.06.2022, ka emëruar Bordin e OShP, në përbërje të plotë, pothuajse pas një (1) viti prej kur Bordi paraprak kishte mbetur pa mandat.<sup>3</sup> Më 12.07.2022, Bordi ka marr vendim që të gjitha ankesat, të cilave iu kishte kaluar çdo afat ligjor për vendimmarrje, të mos i nënshtrohen procesit të vendimmarrjes, por të hidhen si të jashtë afatshme për shqyrtim dhe vendosje meritore, kurse të gjithë OE-ve nga cilësia e tyre si ankues, u janë kthyer mjetet e deponuara në emrin e tarifës ankimore.<sup>4</sup>

Më 25 tetor 2022, Anëtarja e Bordit Nita Bejta jep dorëheqje duke reduktuar numrin e anëtarëve të bordit në 4. Qeveria vetëm pas 4 muajve publikon konkursin për anëtarë të bordit. Ndërkohë, që rekomadnimi për emërimin e një (1) anëtarë të Bordit të OShP-së, nga Organi i Pavarir Përzgjedhës, Kuvendit i dorëzohet shtatë (7) muaj pas mbylljes së konkursit. Ndërkohë, pas propozimit të Qeverisë më 13 korrik 2023, Kuvendit i Republikës së Kosovës me votat e mazhorancës parlamentarë shkarkon nga pozita anëtarën e Bordit Kimete Gashi, me arsyetimin se e njëjta ka bërë shkelje të rëndë të etikës profesionale.<sup>5</sup> Propozim-vendimin e Qeverisë para Kuvendit e kishte bërë Ministria e Punëve të Jashtme pa prezantuar asnjëlloj raporti të vlerësimit dhe hetimit të shkeljes etike profesionale nga ana e Kimete Gashit, si dhe arsyetimin se kush, cili organ e ka vlerësuar shkeljen etike dhe profesionale të pretenduar nga Qeveria.<sup>6</sup> Andaj, shkarkimi i Kimete Gashit, përveç se i paarsyetuar në rrugë ligjore dhe institucionale dhe i diksutueshëm në

---

<sup>1</sup> Për më shumë shih, neni 100 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

<sup>2</sup> “OShP peng i Politikës”, Shkurt, 2021, i publikuar nga INPO, I qasshëm në: <https://inpo-ks.org/ep-content/uploads/2022/02/Raport-OShP-peng-i-politik%C3%ABs-I.pdf>

<sup>3</sup> “Emërohet Bordi i OShP”, Ekonomia Online, qasur për herë të fundit më 5 dhjetor 2023, në këtë vegës <https://ekonomiaonline.com/emerohet-bordi-i-ri-i-oshp-se/>

<sup>4</sup> Raporti vjetor i punës së OShP-së për vitin 2022, i qasshëm në: <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=18>

<sup>5</sup> Transkripta e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur me 13 korrik 2023

<sup>6</sup> Po aty.

aspektin e ndëryrjes dhe kontrollit politik në organe të pavaruara, ai lë vakant edhe një pozitë të anëtarit të OShP-së, respektivisht lë Bordin në përbërje të vetëm tre (3) anëtarëve.

Kësisoj, nga janari e deri në pjesën e parë të korrikut 2023, OShP ka funksionuar me katër (4) anëtarë të Bordit, ndërkaq nga pjesa e dytë e korrikut e deri më 30 shtator ka funksionuar me tre (3) anëtarë.

Tutje gjatë periudhës janar – shtator, OShP përveç se mungesën e plotë të Bordit, pra ajo është përballur edhe mungesë të stafit të administratës dhe kapaciteteve humane dhe financiare të insitucionit për mes së cilave do të mund të lehtësonte dhe organizonte më mirë stafin e administratës për të suportuar punën e Bordit të OShP-së.

#### 4. Pasqyrë e përgjithshme e ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara

Gjatë periudhës janar – shtator 2023 në OShP janë deponuar gjithsej 748 ankesa. Ankesa të zgjidhura rezultojnë të jenë 632 sosh apo mbi 84% e ankesave janë zgjidhur brenda kësaj periudhe, ndërkaq në shqyrtim janë 116 ankesa.

Të pranuar	Te zgjidhura	Në shqyrtim
748	632	116

**Tabela 1:** Totali ankesave në OShP.

INPO ka analizuar afatet ligjore të shqyrtimit të prokurimit, respektivisht nxjerrjes së vendimve për ankesat e zgjidhura dhe ka gjetur se shumica e vendimeve apo ankesave janë zgjidhur jashtë afatit ligjor. Nga gjithsej 632 ankesa të zgjidhura, vetëm 143 prej tyre apo rreth 23% janë zgjidhur brenda afatit ligjor. 489 ankesa të tjera janë zgjidhur jashtë afatit apo mbi 77%.

Brenda afatit	Jashtë afatit
143	489

**Tabela 2:** Afatet e zgjidhjes së ankesave në OShP.

Po ashtu, nga 143 ankesat e zgjidhura brenda afatit ligjor INPO ka gjetur se mbi 77% e tyre, apo 111 sosh janë vendime procedurale për zgjidhjen e ankesave në shqyrtim paraprak të tilla si: (i) *Aprovohet kërkesa për terheqje të ankeses*, (ii) *Hidhet si e jashtaftashme*, (iii) *Hidhet si e palejuar*, (iv) *Hidhet si jo e plotë*, (v) *Përfundon, pajtim i arritur mes palëve*.

Pra vetëm në 32 raste të ankesave apo 22% janë zgjidhur bazuar nën gjykimin e Panelit Shqyrtues mbi çështjen meritore, brenda afatit ligjor.

Tutje, nga 489 ankesa të zgjidhura jashtë afatit ligjor, INPO ka gjetur se për 48 ankesa janë nxjerrë vendime procedurale për zgjidhjen e ankesave në shqyrtim paraprak të tilla si (i) *Aprovohet kërkesa për terheqje të ankeses*, (ii) *Hidhet si e jashtaftashme*, (iii) *Hidhet si e palejuar*, (iv) *Hidhet si jo e plotë*, (v) *Përfundon, pajtim i arritur mes palëve*. Rrjedhimisht, as shqyrtimi paraprak i lëndës nuk është bërë brenda 34 ditëve.

Në këtë kuptim, janë gjithsej 159 vendime brenda dhe jashtë afatit ligjor, të shqyrtimit të ankesave pa angazhim të paneleve shqyrtuese për vendimmarrje meritore. Tutje 116 ankesa të tjera që janë në shqyrtim, INPO ka gjetur se edhe këtyre ankesave ju ka skaduar afati i shqyrtimit bazuar në

kalkulimin e afateve ligjore nga 30 shtatori 2023 kur edhe është deponuar ankesa e fundit për periudhën raportuese (Ankesa Nr.748/23) deri në ditën e 34-të afatit ligjor e që është 5 nëntor 2023.

Tutje në këtë raport, analiza e INPO-s është e fokusuar vetëm në lëndët për të cilat është vendosur mbi çështjen meritore nga panelet shqyrtuese, pra që ka një raport të ekspertit shqyrtues dhe një vendim të panelit shqyrtues. Nga mostra e analizës janë përjashtuar 159 ankesat për të cilat nuk ka pasur angazhim të paneleve shqyrtuese dhe 116 ankesat e tjera që janë në shqyrtim dhe për të cilat nuk ka vendim të paneleve shqyrtuese pavarësisht së afati ligjor për vendimmarje ka skaduar. Rrjedhimisht, në fokus të kësaj analize janë 473 ankesa, respektivisht vendime.

## 5. Ndryshimet e rregullave të “lojës”

OShP organizon punën e saj në një numër të paneleve shqyrtuese. Varësisht nga vlera apo madhësia e kontratës së propozuar apo bazuar në vështirësinë ose rëndësinë e çështjes së ngritur nga ky rast, OShP është përgjegjëse për nxjerrjen e rregullave të brendshme në lidhje me emërimin e anëtarëve për një panel shqyrtues, të cilat nënshkruhen nga Kryetari i OShP-së. Paneli shqyrtues mund të përbëhet nga një, tre ose pesë anëtarë.<sup>7</sup>

Përbërja e paneleve shqyrtuese në OShP është rregulluar me Rregulloren e Punës së OShP-së, e cila miratohet nga Bordi i OShP-së.

Nga viti 2020 deri në Qershor 2023, panelet shqyrtuese janë organizuar bazuar në nenin 21 të Rregullores 01/2020 të punës së OShP-së, e cila ka paraparë që për (i) shqyrtimin e lëndëve të ankesave që nuk e tejkalojnë vlerën deri 30,000.00Eur, të themelohet paneli shqyrtues prej një (1) anëtar, (ii) për shqyrtimin e lëndëve të ankesës që kalojnë 30,000.00Eur por që janë nën 500,000.00Eur, të themelohet paneli prej tre (3) anëtarëve dhe për (iii) vlerën e ankesave mbi 500,000.00Eur të themelohet paneli shqyrtues në përbërje të plotë të bordit, pra prej pesë (5) anëtarësh. Po ashtu, në rastet kur për arsye objektive një anëtar i panelit nuk mund të marr pjesë në panelin pesë (5) anëtarësh, Kryetri i Bordit të OshP-së ka të drejtë ta ndryshoj përbërjen e panelit nga pesë (5) në tre (3) anëtarë.

Ky rregull, është ndryshuar më 09.08.2023, ku Bordi aktual i OShP-së e ka plotësuar dhe ndryshuar rregulloren 01/2020 të datës 03.03.2020, respektivisht ka ndryshuar vetëm nenin 21, i cili rregullon mënyrën e themelimit dhe përbërjes së paneleve shqyrtuese. Sipas Rregullores për ndryshimin e Rregullores 01/2020 për punën e OShP-së, për lëndët e ankesave më vlerë deri në 300,000.00Eur do të themelohet paneli shqyrtues prej një (1) anëtar dhe (ii) për lëndët e ankesave me vlerë mbi 300,000.00Eur por jo më shumë se 1,000,000.00Eur të themelohet paneli shqyrtues në përbërje kolegjiale prej (tre) anëtarësh.<sup>8</sup>

Ndryshimi i rregullave të themelimit të paneleve shqyrtuese, respektivisht të shqyrtimit të ankesave sipas Kryetares së OShP-së ka ardhë si rezultat i mbingarkesës së Bordit më lëndë, pasi

<sup>7</sup> Neni 106, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

<sup>8</sup> Rregullore për amendamentimin e Rregullores Nr/01/2020 për punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, I qashtëm në: <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=6>

që në kohën e vendimit për ndryshim të rregullores, përbërja e bordit ka qënë jo e plotë (me 4 anëtarë), pasi anëtarja Nita Bejta ishte dorëhequr, kësisoj OShP-ja ishte e “ngulfatur” më lëndë. Në këtë drejtim, pritej rritja e efikasitetit të punës së OShP-së, respektivisht paneleve shqyrtuese në zgjidhjen e ankesave.<sup>9</sup>

## **5.1. Ndryshimi i kundërligjshëm rregullave të “lojës” dhe mungesa e transparencës**

Procesi i amendamentimit të Rregullores së punës së OShP-së i datës 09.08.2023, nën vlerësimin e INPO-s është përcjellur me mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe është bërë në kundërshtim me ligjin. Sipas LPP-së “në çdo rast kur KRPP, OSHP, AQP planifikon të nxjerrë një akt nënligjor për zbatimin e këtij ligji, janë të obliguara që draftin e aktit nënligjor t’a vënë në disponim për publikun dhe palët e interesuara, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë për të komentuar draftin.”<sup>10</sup>

INPO ka gjetur se OShP-ja nuk e ka zbatuar obligimet ligjore gjatë procesit të amendamentimit të Rregullores Nr.01/2020 së Punës. Drafti i rregullores së datës 09.08.2023 nuk është publikuar në ueb faqen e zytare të OShP-së dhe as nuk është ndërmarrë ndonjë proces i konsultimit publik dhe me palë të interesuara. OShP as pas ndryshimit të Rregullores nuk ka bërë ndonjë njoftim për AK-të dhe për OE- të dhe palët e tjera me interes në shqyrtimin e prokurimit, se rregullat e themelimit të paneleve kanë ndryshuar.

INPO për këtë ndryshim është vënë në dijeni nga monitorimi i vazhdueshëm i vendimeve të OShP-së. Tutje, INPO ka gjetur se ndryshimit të Rregullores së datës 09.08.2023, nuk i ka paraprirë asnjë analizë e cila justifikon ndryshimin e rregullores, bazuar në fondin e ankesave të grumbulluara, kohëzgjatjes së shqyrtimit të ankesës, shprëndarjes së lëndëve në mes anëtarëve të bordit, dhe mesatares së vendimeve të nxjerra sipas kapaciteteve që kanë pasur në dispozicion. Rrjedhimisht, Bordi nuk ka pasur para vetës asnjë parashikim të bazuar në indikatorë, se deri në çfarë mase ndryshimi i Rregullores do të përmirësonte performancën e OShP-së dhe efikasitetin në trajtimin e ankesave.

Gjatë analizimit të proceverbaleve të mbledhjeve të Bordit të OShP-së dhe vendimeve rreth ndryshimit të rregullores së punës, INPO ka gjetur se OShP-ja fillimisht në Qershor 2023, e kishte ndryshuar për herë të parë Rregulloren e punës, duke ndryshuar poashtu vetëm rregullat e themelimit të paneleve shqyrtuese, ku në panele individuale kishte vendosur të trajtoheshin ankesat e lëndëve me vlerë deri në 100,000.00Eur.<sup>11</sup> Gjithashtu, edhe neni 32 i rregullores 01/2020, i cili rregullon mënyrën e shqyrtimit të kërkesave të AK-ve për diskualifikim të OE-ve ishte plotësuar dhe ndryshuar, duke i dhënë të drejtën Bordit të OShP-së që të autorizoj ekspertët shqyrtues për ta analizuar në fazën e shqyrtimit paraprak kërkesën e AK-së, për inicimin e procedurës dhe ndërmarrjen e masave ndaj OE-ve për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme apo falsifikimit të dokumenteve. Po ashtu, as kjo Rregullore për plotësim/ndryshimin e Rregullores Nr.01/2020 të Punës nuk i ishte nënshtuar mekanizmave të konsultimit publik dhe as

<sup>9</sup> Takim me Kryetaren e Bordit të OShP-së më 24.11.2023

<sup>10</sup> Neni 10, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

<sup>11</sup> Procesverbali Nr.628/23 nga Mbledhja e Bordit të OShP-së, e datës 05.06.2023, i siguruar përmes kërkesës për Qasje në Dokumente Publike.

për hyrjen në fuqi të saj, OShP nuk ka njoftuar publikun dhe palët me interes. OShP-ja gjatë komunikimeve<sup>12</sup> me ekipin e monitoruesve të INPO-s rreth Rregullores për amandamentimin e Rregullores 01/2020, e cila ka hy në fuqi më 09.08.2023, asnjeherë nuk e ka përmendur se Rregullorja e punës 01/2020 e datës 03.03.2020, fillimisht është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për amandamentim e Rregullores 01/2020, të datës 23.06.2023, zbatimi i së cilës nuk dihet se kur ka filluar pasi që nuk dihet se kur është publikuar në ueb faqen e OShP-së<sup>13</sup> dhe as sot nuk figuron e publikuar. Këtë Rregullore INPO e ka siguruar më 04.12.2023, apo vetëm 3 ditë para publikimit të këtij raporti.

Kësisoj, Rregullorja për amandamentimin e Rregullores Nr.01/2020, e datës 09.08.2023 e cila ndryshon vetëm të nenin 21 të rregullores Nr.01/2020 të datës 03.03.2020, i cili parasheh që për shqyrtimin e lëndëve të ankesave me vlerë deri në 300,000.00Eur të themelohet paneli shqyrtues prej një (i) anëtari dhe (ii) për lëndët e ankesave me vlerë mbi 300,000.00Eur por jo më shumë se 1,000,000.00Eur të themelohen paneli shqyrtues në përbërje kolegjiale prej (tre) anëtarësh është i kundërligjshëm për këto arsye:

1. Rregullorja është hartuar me qëllim të amandamentimit të Rregullores Nr.01/2020 të Punës së OShP-së dhe nuk e trajton në asnjë nen të saj Rregulloren për Amandamentimin e Rregullores Nr.01/2020 të datës 23.06.2023, e cila po zbatohet nga Bordi i OShP-së gjatë procedimit të ankesave në atë periudhë kohore. Pra, rregullorja e datës 09.08.2023 përfshinë ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të nenin 21 dhe 32 të Rregullores Nr.01/2020 dhe fshinë në tërësi paragrafët 4 dhe 5 të nenit 21 (Përbërja e Panleve Shqyrtuese) të Rregullores Nr.01/2020 për Punën e OShP-së dhe obligon të zbatoj paragrafët 2.2 dhe 2.3 të kësaj Rregullore ku parashihet themelimi i paneleve individuale për lëndët e ankesave deri në 300,000.00Eur dhe paneleve prej tre (3) anëtarëve kur vlera e lëndës së ankesave tejkalon shumën e 300,000.00Eur dhe nuk e tejkalon vlerën 1,000,000.00Eur.<sup>14</sup> Pra, kjo rregullore nuk e përfillë fare Rregulloren e datës 23.06.2023, e cila kishte ndryshuar përmbajtjen e nenin 21 dhe 32 të Rregullores 01/2020.
2. Rregullorja nuk trajton nenin 32 i cili paraqitet si qëllim i amandamentimit Rregullores në nenin I të saj. Pra, nuk dihet nëse neni 32 i Rregullores 01/2020, i amandamentuar me Rregulloren e datës 23.06.23 është duke u aplikuar nga OShP-ja apo është shfuqizuar.
3. Me këtë Rregullore nuk shfuqizohen ndryshimet e nenit 21 dhe 32 të aprovuara me Rregulloren e datës 23.06.2023.<sup>15</sup>

---

<sup>12</sup> Shënim: INPO gjatë periudhës shtator – nëntor 2023, ka kërkuar qasje në dokumente publike dhe ka kërkuar sqarime me shkrim rreth procesit të amandamentimit të rregullores 01/2020, e cila është në fuqi. Po ashtu, janë zhvilluar edhe një takim me Kryetaren e OShP-së nga Drejtorja Ekzekutive e INPO-s.

<sup>13</sup> Shënim: Sipas neni 6 të Rregullores për Amandamentin të Rregullores së Punës Nr.01/2020, konsiderohet i plotëfuqishëm nga data e nënshkrimit të kryetarës së OShP-së dhe publikimit në ueb faqe. Nënshkrimi i rregullores nuk mbanë datë. Në faqen e parë të Rregullores figuron data 5 qershor 2023, ndërkaq data e protokollimit është 23 qershor 2023.

<sup>14</sup> Neni 2 i Rregullores për Amandamentimin e Rregullores Nr.01/2020 për Punën e OShP, i datës 09.08.2023, i qashëm në ueb faqen zyrtare të OShP-së në këtë vegës: <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=6>

<sup>15</sup> Neni 1, i Rregullores për Amandamentimin e Rregullores Nr.01/2020 për Punën e OShP, i datës 09.08.2023, i qashëm në ueb faqen zyrtare të OShP-së në këtë vegës: <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=6>

4. Në procesverbalin e datës 05.06.2023 të mbledhjes së Bordit të OShP-së, i cili është konsideruar si bazë në preambulën e Rregullores, nuk figuron askund se Bordi ka diksutuar dhe votuar për themelimin e paneleve individuale për trajtim të ankesave me vlerë deri në 300,000.00Eur.<sup>16</sup> Rrjedhimisht, bazuar në këto dokumente nuk dihet se kush dhe si ka vendosur për ndryshimin e themelimit të paneleve shqyrtuese për këto vlera të lëndëve të ankesave. Madje as në një komunikimin më shkrim mes OShP-së dhe INPO-s një gjë e tillë nuk është sqaruar.
5. OShP nuk ka respektuar standardet minimale të konsultimit publik dhe nuk ka vënë në dispozicion të publikut për komentin draftin e Rregullores kështu duke vepruar në kundërshtim me nenin 10 të LPP-së, i cili e obligon OShP-në që gjatë nxjerrjes së një akti nënligjor për zbatimin e LPP-së, draftin e aktit nënligjor t'a vëjë në disponim për publikun dhe palët e interesuara, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Kësisoj, rregullat për themelimin dhe përbërjen e paneleve shqyrtuese në OShP i ishin nënshtruar dy (2) herë ndryshimeve të përcjelluara me shkelje ligjore të argumentuara më lartë, dhe mungesës të transparencës së plotë ndaj publikut dhe palëve të interesuara.

INPO ka gjetur se në kohën e ndryshimit të Rregullores shumica e lëndëve të deponuara në OShP apo 68.7% e tyre janë lëndë me vlerë deri nga 30,000.00 Eur deri në 300,000.00Eur.

Ekspertë të fushës juridike thonë se, praktikrat dhe standardet ndërkombëtare që ndërlidhen me prokurimin publik përcaktojnë se politikat apo korniza ligjore që rregullojnë këtë fushë si në aspektin procedural ashtu edhe atë material duhet të karakterizohen me qartësi, koherencë dhe vazhdimësi të bazuara në dëshmi dhe konsultime publike me të gjitha palët e interesit. “Çdo ndryshim apo plotësim i rregullores pa ndonjë arsyetim të bazuar, pa konsultime publike dhe pa përfshirjen e grupeve të interesit përbën shkelje të ligjit dhe ndërtim të praktikave të këqija të cilat cenojnë integritetin e proceseve të shqyrtimit të ankesave brenda OSHP”.<sup>17</sup> Përveç shkeljeve ligjore dhe praktikës së keqe të ndërtuar nga OShP, ndryshimet e paneleve për trajtimin vlerës së ankesave me kapërcime kaq të mëdha, nga 30,000.00Eur në 300,000.00Eur, pa zbatuar procedura ligjore krijojnë dhe pasiguri juridike për palët dhe cenojnë integritetin e procedurës së shqyrtimit të ankesës.

## **6. Statistikat e numrit ankesave sipas vlerës para amendamentimit të rregullores**

Nga 1 janar e deri me 9 Gusht 2023 në OShP janë deponuar gjithsej 558 ankesa apo 2.5 ankesa për ditë. Ndërkaq, analiza e gjendjes së shqyrtimit të ankesave para amendamentimit të Rregullores përfshinë vetëm ankesat që kanë vendime të paneleve shqyrtuese dhe nuk janë përfshira ankesat e zgjidhura në shqyrtim paraprak. Andaj kësisoj ankesat apo vendimet të trajtuara në këtë periudhë janë 420 ankesa, respektivisht vendime.

<sup>16</sup> Procesverbali i mbledhjes së Bordit të OShP-së, i datës 05.06.2023, i siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

<sup>17</sup> Intervistë me Ehat Miftaraj, Drejtor Ekzekutiv i insitutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), më 25 nëntor 2023, nga Albulena Nrecaj.

304 apo 72.4% e 420 ankesave janë ankesa për kontrata vlera e parashikuar e të cilave është deri në 300,000.00Eur, ndërsa 116 apo 27.6% prej tyre janë ankesa për kontrata mbi vlerën 300,000.00Eur.

Nga këto 304 ankesa, 209 apo 68.7% ankesa për kontrata vlera e parashikuar e të cilave është nga 30,000.00Eur deri në 300,000.00Eur. Kjo statistikë bazuar në analizën e INPO-s ka nxitur OShP-në që të ndryshojë rregullat për themelimin e paneleve shqyrtuese.

		Të zgjidhura para amandamentimit	Të zgjidhura pas amandamentimit
Të deponuara para amandamentimit	304	213	91
Të deponuara pas amandamentimit	38	N/A	38

**Tabela 3:** Ankesat për kontratat me vlerë deri në 300,000.00Eur.

## 7. Efikasiteti i shqyrtimit të prokurimit sipas rregullave të reja, në panele individuale

INPO ka vlerësuar efikasitetin e trajtimit të ankesave në panele shqyrtuese para dhe pas ndryshimit të Rregullores së Punës të datës 09.08.2023. Në fokus të analizës rreth efikasitetit janë lëndët për të cilat është vendosur mbi çështjen meritorë nga panelet shqyrtuese, pra që ka një raport të ekspertit shqyrtues dhe një vendim të panelit shqyrtues.

Siç është paralajmëruar me lartë në këtë raport, nga mostra e analizës janë përjashtuar 159 ankesat për të cilat nuk ka pasur angazhim të paneleve shqyrtuese dhe 116 ankesat e tjera që janë në shqyrtim dhe për të cilat nuk ka vendim të paneleve shqyrtuese pavarësisht së afati ligjor për vendimarrje ka skaduar. Rrjedhimisht, në fokus të kësaj analize janë 473 ankesa, respektivisht vendime.

INPO ka analizuar përbërjen e paneleve shqyrtuese për këto 473 ankesa, në përgjithësi pa i ndarë ankesat në bazë të vlerës dhe në bazë të amandamentimit të rregullores. Gjetjet tregojnë se 244 ankesa janë shqyrtuar nga panele individuale, ndërsa 229 ankesa janë shqyrtuar nga panele në përbërje tre (3) anëtarsh.

Pra, shumica e ankesave në OShP janë zgjidhur nga panelet individuale të shqyrtimit të prokurimit, i cili vë në pikëpyetje funksionimin e OShP si organ kolegjal në shqyrtimin e prokurimit.


Gjetjet e hulumtimit tregojnë se OShP nuk e ka rritur efikasitetin e punës, respektivisht paneleve shqyrtuese në procedimin e ankesve dhe vendimarrjes për to.

Tutje, INPO ka mbledhur dhe analizuar të dhenat për 244 ankesa kur vendimet janë marrë me përbërje të paneleve individuale, para dhe pas ndryshimit të Rregullores së publikuar më 09.08.2023, dhe të gjeturat janë si më poshtë:

Emrat e panelisteve	Para ndryshimit të Rregullores	Pas ndryshimit të Rregullores	Totali
Agon Ramadani	17	27	44
Kimete Gashi	36	0	36
Vedat Poterqoi	38	68	106
Vjosa Gradinaj	27	31	58
<b>Total:</b>	<b>118</b>	<b>126</b>	<b>244</b>

**Tabela 4:** Numri i lëndëve të shqyrtuara sipas anëtarëve të OShP.

Siç vërehet, në tabelën e mësipërme Anëtarët e Bordit, Vedat Potërqoi dhe Agon Ramadani si panelist individual, kanë pasur rritje signifikante të trajtimit të ankesave pas ndryshimit të rregullores. Ndërkaq, Kimete Gashi nuk ka qenë anëtare e Bordit në kohën kur ka hyrë në fuqi Rregullorja. Si dhe përfshirja e kryetares së Bordit, Vjosa Gradinaj në panele individuale ka pësuar një rritje të lehtë. Në numrin e vendimeve të nxjerra nga Vjosa Gradinaj nuk përfshihen vendimet e shqyrtimit paraprak të prokurimit, apo vendimet që proceduralisht nënshkruhen nga Kryetarja.



**Grafika 1:** Shprehur në përqindje numri i ankesave të shqyrtuara sipas anëtarëve të OShP-së.

Shprehur në përqindje, vërejmë se pothuajse gjysma e lëndëve të trajtuara në panele individuale apo 44% është bërë nga Vedat Potërqoi, pasuar nga Kryetarja e Bordit, Vjosa Gradinaj me 24%.



## **8. Vendimet e paneleve individuale pas ndryshimit të rregullores**

Gjatë periudhës pas amendamentimit të “Rregullores së Punës” pra për periudhën 10 gusht - 30 shtator në OShP janë deponuar gjithsej 190 ankesa, apo mesatarisht 3.5 ankesa për ditë. Pra në këtë periudhë kemi një rritje të lehtë të mesatares së ankesave për ditë krahasuar me periudhën para amendamentimit të Rregullores së Punës.

Për të analizuar efektshmërinë e amendamentimit të Rregullores, INPO ka analizuar kohëzgjatjen mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e 118 ankesave në panele individuale para amendamentimit të Rregullores dhe 126 ankesave të zgjidhura në panele individuale pas amendamentimit të Rregullores. Shumë nga 126 ankesat e trajtuara pas amendamentimit të Rregullores janë deponuar në OShP para 09.08.2023. Kësisoj, OShP nuk ka bërë ndarje të trajtimit apo shqyrtimit të ankesave sipas rregullave që kanë qenë në fuqi në kohën e deponimit të tyre, por i ka vazhduar të shqyrtoj sipas Rregullores së amendamentuar më 09.08.2023. Kështu, përveç shkeljes së parimeve ligjore që ankesa të shqyrtohet bazuar në rregullat që kanë qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja, edhe analizimi i efikasitetit të vendimmarrjes për ankesat në këtë periudhë është vështirë i matshëm. INPO vlerëson se vetëm pas përfundimit të vitit një analizë e tillë mund të bëhet.

Tutje, bazuar në fokusin e kësaj analize koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese para amendamentimit për kontratat vlera e parashikuar e të cilave është deri në 300,000.00 është 53 ditë, ndërsa koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese pas amendamentimit për kontratat vlera e parashikuara e të cilave është deri në 300,000.00Eur është 63 ditë.

Edhe pse është amendamentuar rregullorja me qëllim të zgjidhjes sa ma të shpejtë të ankesave, INPO ka gjetur që përkundrazi koha mesatar shprehur në ditë është rritur nga 53 ditë për zgjidhjen e një ankese para amendamentimit të rregullorës në 63 ditë pas amendamentimit të rregullores.

Tutje INPO ka analizuar se sa nga këto ankesa janë zgjidhur brenda afatit. Nga 118 ankesat e zgjidhura para amendamentimit të rregullores, vetëm 19 ankesa janë të zgjidhura brenda afatit ligjor. Nga 126 ankesat e zgjidhura pas amendamentimit të rregullores vetëm 3 janë zgjidhur brenda afatit ligjor.

## **9. Kohëzgjatja e shqyrtimit të ankesave dhe top vendimet më të vonuara**

INPO ka analizuar në përgjithësi çështjen e afateve kohore për zgjidhjen e ankesave të parashtruara në OShP, pra për 473 ankesat të cilat janë në fokus të këtij hulumtimi.

Sipas gjetjeve të INPO-së nga 473 ankesat e trajtuara nga bordi i OShP-së, vetëm 32 apo 6.8% e ankesa janë zgjidhur brenda afatit ligjor ndërsa 441 apo 93.8 janë zgjidhur pasi që ka kaluar afati ligjor prej 34 ditësh, për shqyrtimin e tyre.

Për të analizuar efektin e rregullores, INPO ka krahasuar ankesat dhe vendimet për to, në dy periudha, para dhe pas amendamentimit.

Nga 473 ankesat që janë fokus i kësaj analize 420 prej tyre i përkasin periudhës 1 janar – 9 gusht 2023. Nderkaq, 53 ankesa janë zgjidhur në periudhën 10 Gusht – 30 shtator 2023, pra pas

amandamentimit të Rregullores. Asnjë ankesë nuk është zgjidhur brenda afatit ligjor pas amendamentimit të Rregullores së Punës. Mesatarja e vendimarrjes pas amendamentimit është 53 ditë për 53 ankesat e deponuara.

Në përgjithësi për 473 ankesat për të cilat ka pasur angazhim të paneleve shqyrtuese, koha mesatare shprehur në ditë për trajtimin/shqyrtimin e një ankesë të deponuar pranë Organit Shqyrtues të INPO-s sipas gjetjeve të INPO-së është 65 ditë.

		Të zgjidhura para amendamentimit	Të zgjidhura pas amendamentimit
Të deponuara para amendamentimit	420	296	124
Të deponuara pas amendamentimit	53	N/A	53

**Tabela 4:** Ankesat për të gjitha kontratat para amendamentimit të rregullores.

INPO ka evidentuar edhe ankesat me afatin me të gjatë të vendimmarrjes. Siç vërehet në tabelën e më poshtme, janë 6 ankesa për shqyrtimin e së cilave OShP-së i janë dashur mbi 128 ditë. Këto 6 ankesa janë të deponuara para amendamentimit të rregullores dhe 5 nga këto janë zgjidhur para amendamentimit të saj. Ankesa 407/23 është zgjidhur pas amendamentimit të rregullores.

Nr. i ankesës	Emri i aktivitetit	OE ankues	AK	Vlera e parashikuar e kontrates	Kohëzgjatja në ditë
19/23	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica	Instituti për shkencë dhe Teknologji "Insi" SH.P.K	Komuna Prishtinë	400,000.00	196
74/23	Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë-vazhdimi i punimeve	AAG Projekt SH.P.K	Ministria e Punëve të Brendshme	939,633.44	165
49/23	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish	El Bau SH.P.K	Komuna Gjilan	100,000.00	138
407/23	Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse	Triangle SH.P.K	Komuna Mamushë	65,000.00	130
90/23	Ofrimi i Shërbimeve këshilluese profesionale për hartimin e strukturës organizative të ndërmarrjes dhe rregullores për sistematizimin e vendeve të punes	Nexia KS SH.P.K	NH Iber Lepenc Sh.A.	20,000.00	128
22/23	Shërbime të Dezinfektimit, Deratizimit, Dezinsektimi të objekteve të UP-së	Vlera SH.P.K	Universiteti i Prishtinës	195,000.00	128

**Tabela 5:** Vendimmarrjet më të vonuara,

## 10. (D)efektet e shqyrtimit të ankesave dhe pasojat

Bordi i OShP duhet t'u sigurojë palëve se shqyrtimi i prokurimit bëhet përmes veprimeve dhe procedurave të ligjshme, të shpejta, efektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Vonesat e vendimmarjes në OShP çënojnë rëndë integritetin e insitucionit dhe çënojnë të drejtat e palëve për përdorimin e mjeteve juridike dhe të sigurisë ligjore pasi që nuk janë në përputhje me pritjet legjitime të paleve që ankesat e tyre të zgjidhen brenda sistemit të afateve të njohura tashmë për ta. Po ashtu, vonesat në vendimmarje vënë në çënojnë besimin e publikut në aftësinë e OShP-së për të ndarë drejtësi në prokurimin publik.

Bazuar në nenin 117 të LPP-së, afati për nxjerrjen e vendimeve meritorë nga Panelet Shqyrtuese është 34 ditë.

Bordet e kaluara të OShP-së përfshirë edhe Bordin aktual për shkak të bordeve të pa plota ose jo funksionale, kanë nxjerrur konkluzione<sup>18</sup> apo edhe vendime<sup>19</sup> ku kanë argumentuar se ankesat që u ka skanduar afati i shqyrtimit prej 34 ditëve nuk do të shqyrtohen. Në këtë kuptim, përveç afateve ligjore të përcaktuara me LPP-në por edhe me parimet e përgjithshme të procedurës administrative, këto vendime kanë krijuar standardin tjetër ligjor që për ankesat që u ka skaduar afati i shqyrtimit, të mos nxirren vendime fare.

Bazuar në këtë analogji vendimet e nxjerra jashtë afatit ligjor janë në kundërshtim të plotë me parimin e ligjshmërisë duke qenë se janë nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në kundërshtim me rregullat e përgjithshme administrative brenda kompetencave të OShP-së dhe në shpërputhje me qëllimin e shqyrtimit të prokurimit brenda afatit të arsyeshëm kohor. Kësisoj, OShP gjatë vendimmarjes së saj ka përdorur edhe qasje diskriminuese për Operatorë Ekonomikë, ku për shkak të skadimit të afateve ligjore, nuk ua ka shqyrtuar ankesat, ndërkohë që tani, shumica e vendimeve të OShP-së janë jashtëafatshme.

Në anën tjetër, vonesat në vendimmarje çënojnë të drejtat e palëve të përfshira në shqyrtimin e prokurimit, rrisin rrezikun e padive kundër mosnxjerrjes së aktit administrativ apo nxjerrjes së aktit jashtë afateve ligjore duke përfshirë kërkesat për kompensimin e dëmit, vlerën e së cilit nuk mund ta definojmë në këtë raport. Po ashtu, këto vonesa rezultojnë me bllokimin e proceseve të prokurimit të cilat duhet të jenë të shpejta dhe efikase, shkaktojë problem financiare në organizata buxhetor dhe mbi të gjitha pengojnë zhvillimin ekonomik. Si pasojë e vonesave është rritur edhe numrin e kontratave të lidhura përmes procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë nga ana e AK-ve, me cka OShP indirekt kontribuon në kufizimin e konkurrencës së barabartë të OE-ve për ofertim kur përdoren këto procedura, si dhe rritjen e rrezikut të keqpërdorimit të parasë publike përmes këtyre procedurave.

Një gjetje tjetër tregon se gjatë shqyrtimit të ankesave pas ndryshimit të Rregullores, OShP ankesat e pranuar para ndryshimit të Rregullores ka vazhduar ti trajtojë sipas Rregullores së

<sup>18</sup> Konkluzioni numër 174/14 i datës 27.03.2014 i Organit Shqyrtues të Prokurimit, Prishtinë, faqe 27, i siguruar përmes Kërkesës për qasje në dokumente publike.

<sup>19</sup> Shënim: OShP pas konstituimit të Bordit, ka publikuar një njoftim ku ndër të tjerash ka njoftuar AK-të dhe OE-të se "...Të gjitha ankesat të cilat janë pranuar para datës 8 qershor 2022 nuk do të shqyrtohen pasi afati ligjor për shqyrtim ka kaluar. OShP do të nxjerrë vendim për secilën nga këto ankesa". Njoftimin mund ta gjeni në platformën elektronike oshp.ks-gov.net në këtë vegës <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=15>

amandamentuar dhe jo sipas rregullave që kanë qenë në fuqi kur është deponuar ankesa. Ndryshimi i rregullave të brendshme me efekt prapaveprues nuk mund të bëhet përveç nëse e njëjta shkon në favor të paleve. Ngjashëm me këtë, edhe aplikimi i një norme me efekt retroaktiv ndalohet përveç nëse shkon në favor të palës.<sup>20</sup>

Rrjedhimisht, ndryshimi i rregullave të themelimit të paneleve shqyrtuese nuk kanë rritur efikasitetin e trajtimit të lëndëve por ka çënuar integritetin dhe besimin e publikut dhe paleve të interesuara, duke ngritur dyshime se OShP “po ndërton një kontroll individual mbi vendimmarrjen, ku çënohet cilësia e vlerësimit të çështjes mbi baza meritore dhe rriten gjatat për ndikim në vendimmarrje”.<sup>21</sup>

Tutje, duke pas parasysh se shumica e lëndëve të trajtuara në OShP janë bërë përmes paneleve shqyrtuese individuale, INPO vë në pikëpyetje karakterin e vendimmarjes kolegjiale të OShP-së ashtu sikur është e rregulluar me ligj.

## I I. Vlera dhe lloji i ankesave të (pa)zgjidhura brenda afateve kohore

INPO ka analizuar ankesat për nga vlera dhe lloji i kontratës duke u bazuar në Udhëzuesin NR.001/2023 për Prokurim Publik. Nga 473 ankesa e për të cilat edhe ka vendime të paneleve shqyrtuese sipas llojit dhe sipas vlerës ankesat karakterizohen si në vijim.

Ankesat sipas llojit të kontratës	Numri
Punë	103
Furnizime	195
Sherbime	168
Konkurs projektimi	7
<b>Totali:</b>	<b>473</b>

**Tabela 5:** Ankesat sipas llojit të kontratës

INPO ka analizuar dhe krahasur afatet kohore për zgjidhjen e ankesave sipas dhe sipas vlerës dhe ka gjetur se:

- 4 nga 103 ankesa për llojin punë janë zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese të llojit punë është 68 ditë.
- 15 nga 195 ankesa për llojin furnizime janë zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese të llojit furnizime është 63 ditë.
- 13 nga 168 ankesat për llojin shërbime janë zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese të llojit shërbime është 65 ditë.

<sup>20</sup> Intervistë me Kujtim Kerveshi, Avokat, realizuar me 20 nëntor 2023, nga Albulena Nrecaj.

<sup>21</sup> Po aty.

- 0 nga 7 ankesat për llojin konkurse projektimi janë zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese të konkurse projektimi është 87 ditë.

Ankesat sipas vlerës së kontratës	Numri
Vlerë e madhe	172
Vlerë e mesme	288
Vlerë e vogël	13
<b>Totali:</b>	<b>473</b>

**Tabela 6:** Ankesat sipas vlerës së kontratës

Tutje, INPO ka analizuar dhe krahasur afatet kohore për zgjidhjen e ankesave sipas vlerës së kontratës dhe ka gjetur se:

- 6 nga 172 ankese me vlerë të madhe janë zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese me vlerë të madhe është 70 ditë.
- 26 nga 288 me vlerë mesatare janë zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese me vlerë të mesme është 63 ditë.
- 0 nga 13 ankesat me vlerë të vogël janë zgjidhur zgjidhur brenda afateve ligjore, ndërsa në total koha mesatare shprehur në ditë për zgjidhjen e një ankese me vlerë të vogël është 57 ditë.

## 12. Autoritetet kontraktuese ndaj të cilave ka më së shumti ankese

AK-të me të atakuara me ankese në OShP gjatë periudhës Janar – Shtator 2023 janë Komuna e Prishtinës, Korporata Energjetike e Kosovës, ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, duke u pasuar me pas nga Ministri të tjera dhe komunat. Duke pas parasysh faktin se për një aktivitet të prokurimit mund të jenë ushtruar më shumë së një ankese dhe më qëllim të mos paraqitjes së të dhenavë jo reale rreth AK-ve me më së shumti ankese, INPO ka bërë dallimin sikur në tabelle, në mes të numrit të ankesave në përgjithësi dhe numrin e aktiviteteve të prokurimit ndaj të cilave ka ankesë.

Autoriteti Kontraktues	Numri i ankesave	Numri i aktiviteteve ndaj të cilave ka ankesë
Komuna Ferizaj	12	10
Komuna Gjakovë	15	12
Komuna Gjilan	13	12
Komuna Obiliq	13	7

Komuna Pejë	11	8
Komuna Podujevë	11	10
Komuna Prishtinë	43	36
Komuna Prizren	20	17
KEK-u	29	23
Ministria e Mbrojtjes	12	9
Mjedisit	13	10
Ministria e Punëve të Brendshme	23	16
Policia e Kosovës	25	19

**Tabela 7: AK-të me të atakuara me ankesa në OSHP.**

Tutje, INPO ka evidentuar dy (2) aktivitetet me më së shumti ankesa, respektivisht me nga 4 janë aktiviteti **“Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve”** autoritet kontraktues i së cilës është Ministria e Punëve të Brendshme, dhe aktiviteti **“Zhvarrosja, transporti, arkivoli, vorrosja, vendosja e gureve me mbishkrime”** autoritet kontraktues i së cilës është Korporata Energjetike e Kosovës.

### 13. Kalendarit 116 ankesave në shqyrtim

Siç është shpjeguar në këtë raport 116 ankesat në shqyrtim nuk janë pjesë e analizës. Megjithatë, INPO në këtë kapitull paraqet 5 ankesat me vlerë deri në 300,000.00Eru për të cilat ka vonesa më të mëdha në vendimmarrje.<sup>22</sup> Pra, për këto ankesa edhe pse kanë kaluar mbi 100 ditë OSHP akoma nuk ka nxjerrë vendim për to. Të gjitha këto ankesa janë deponuar pas ndryshimit të rregullores dhe para datës 30 shtator 2023.

Nr. i ankesës	Emri i aktivitetit	OE Ankues	AK	Vlera e parashikuar e kontrates	Kohëzgjatja në ditë
574/23	Furnizim me material Higieniko - Sanitar	Samire Osmani B.I	Komuna Gjilan	126,836.80	114
586/23	Shtuarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekes në objektin e ri të QKMF-s në KK Mamushë	Limit L& B SH.P.K.	Komuna Mamushë	32,942.25	114
600/23	Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	Arianit R. Bytyqi B.I.	Komuna Podujevë	183,750.00	107
604/23	Furnizim me lidhëse elastike	Univers-M shpk	Korporata Energjetike e Kosovës	45,000.00	106
640/23	Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës në Institucionet Arsimore	Anesi SH.P.K.	Komuna Prishtinë	80,000.00	96

**Tabela 8: Ankesat të cilat janë ende në proces deri më 06.12.2023.**

<sup>22</sup> Monitorimi i fundit i statusit të ankesave është bërë më 6 dhjetor 2023, nga monitoruesi Arbër Kabashi.

## 14. Konkluzione

- Historikisht, OShP është përballë me probleme të mos funksionimit të plotë të Bordi, si rezultat i mungesës së vullnetit të qeverive për të plotësuar apo konstituar Bordin.
- Problemet e mos funksionalizmit të OShP-së vijnë si rezultat i ndërhyrjeve dhe kalkulimeve politike në procesin e zgjedhjes së kryetarit dhe anëtarëve të bordit.
- Gjatë periudhës Janar – Korrik, Bordi i OShP-së ka funksionuar me 4 anëtarë, ndërkaq nga korriku deri në shtator vetëm me 3 anëtarë.
- Gjatë këtij 9 muhori në OShP janë depnuar 748 ankesa. Mbi 84% e ankesave janë zgjidhur brenda kësaj periudhe, por vetëm 23% e tyre brenda afatit ligjor. 77% e ankesave në OShP janë zgjidhur jashtë afatit ligjor.
- Ndërkaq në shqyrtim janë 116 ankesa të cilave po ashtu ju ka skaduar afati i shqyrtimit bazuar në kalkulimin e afateve ligjore nga 30 shtatori 2023 kur edhe është deponuar ankesa e fundit për periudhën raportuese (Ankesa Nr.748/23) deri në ditën e 34-të afatit ligjor e që është 5 nëntor 2023.
- Vetëm 32 ankesa nga total 473 ankesa në OshP të cilat janë fokus i monitorimit, janë zgjidhur brenda afatit ligjor.
- Mesatarja e zgjidhjes së ankesave në OShP është 65 ditë.
- OShP në mungesë të përbëjes së plotë të Bordit ka ndryshuar dy herë rregullat për themelimin e paneleve shqyrtuese, duke rritur vlerat e lëndëve të ankesave që do të trajtohen në panele shqyrtuese individuale deri në 900%.
- Ndryshimet e rregullores janë bërë në kundërshtim me LPP-në dhe në mungesë të plotë të transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesuara.
- Ndryshimi i rregullave nuk ka rezultuar me rritje të efikasitetit të punës së paneleve shqyrtuese.
- Edhe pse është amendamentuar rregullorja me qëllim të zgjidhjes sa më të shpejtë të ankesave, INPO ka gjetur që përkundrazi koha mesatare shprehur në ditë është rritur nga 53 ditë, për zgjidhjen e një ankese para amendamentimit të rregullores, në 63 ditë pas amendamentimit të rregullores, për vlerën e lëndëve të ankesave është deri në 300,000.00Eur.
- Pothujse gjysma e lëndëve të trajtuara në panele individuale apo 44% është bërë nga Vedat Potërqoi pasuar nga Kryetarja Vjosa Gradina me 24% të pjesëmarrjes.
- OShP në Rregulloren për amendamentin e Rregullores 01/2020 nuk ka përcaktuar nëse rregullorja ka fuqi prapavepruese, kështu që vazhduar të trajtoj ankesat e deponuara para hyrjes në fuqi të Rregullores sipas rregullave të reja.
- Shumica e lëndëve të trajtuara në OShP janë bërë përmes paneleve shqyrtuese individuale. INPO vë në pikëpyetje objektivitetin dhe karakterin e vendimmarjes kolegjiale të OShP-së.

## 15. Rekomandime

- Qeveria dhe Kuvendi të zbatojnë detyrat dhe kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore në emërimin e anëtarëve të Bordit brenda afatve ligjore, larg ndërhyrjeve politike dhe jo në llogari të grupeve të interesit.
- Kuvendi i Kosovës të sigurohet se anëtarët e OShP-së janë persona me integritet të lartë profesional dhe etik.
- Qeveria dhe Kuvendi të adresoj problemet e paraqitura historikisht të (mos)funksionimit të OShP-së përmes projekt ligjit për Prokurimin Publik, i cili është në fazë të hartimit, siç është rritja e numrit të anëtarëve të OShP dhe definimin e kompetencave dhe përgjegjësi gjatë ushtrimit të mandatit. Duhet të definohet përgjegjësia e anëtarëve që nuk kanë performancë të mirë të punës dhe dorëhiqen kurdo që ata dëshirojnë. Sikur rasti i Nita Bejtës dhe Agon Ramadanit.
- OShP të sigurohet që shqyrtimin e ankesave ta bëjë brenda afateve ligjore duke i shprehur lëndët në mënyrë solidare tek të gjithë anëtarët e bordit dhe jo vetëm dy anëtarë të vendosin për më shumë së gjysmën e ankesave.
- Proceset e nxjerrjes së akteve normative të OShP-së apo plotësim ndryshimi i tyre të bëhet në përputhje të plotë me urdhëresat ligjore dhe parimet e qeverisjes së mirë dhe përfshirjen së publikut në vendimarrje.
- Bordi i OShP të trajtoj gjetjet e këtij raporti me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës dhe rritjes së besimit të publikut në vendimarrjen e OShP-së.



# INPO

Iniciativa për progres

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar ne vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështje sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik.

 +383 (0) 49 354 000

 [info@inpo-ks.org](mailto:info@inpo-ks.org)

 [www.inpo-ks.org](http://www.inpo-ks.org)

